



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI " FAN S. NOLI "
KORÇË

**RAPORT I VLERËSIMIT
TE BRENDSHËM
PËR AKREDITIMIN E PROGRAMEVE TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR DHE TË DYTË MASTER NË
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS DHE
SHKENCAVE HUMANE**

NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

EMËR MBIEMËR

Msc. Maria Dojçe

Msc. Lorena Margo

Msc. Blendi Baze

Msc. Desareda Mero

Ina Kosta (student)

Departamenti i Shkencave Sociale

Departamenti i Matematikës, Informatikës, Fizikës

Departamenti i Infermierisë

Departamenti i Biologji-Kimisë

Departamenti i Shkencave Sociale

VITI AKADEMIK 2015– 2016

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
ORGANOGRAMA.....	19
III - ANALIZA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE DIPLOMAVE	20
Nr. i studentëve të diplomuar viti akademik 2015 – 2016	22
<i>Programi i studimit.....</i>	<i>23</i>
<i>Sistemi i ditës</i>	<i>23</i>
<i>Viti akademik 2015 – 2016.....</i>	<i>39</i>
IX. ANALIZA SWOT E FAKULTETIT	42
ANALIZA SWOT.....	42

HYRJE

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të ciklit të parë të studimit “Bachelor” dhe programeve të ciklit të dytë “Master” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Universiteti “Fan S. Noli” në Korçë, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues realë dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, të përgatisë një raport i cili do të shërbejë si bazë për grupin e vlerësimit të jashtëm, gjatë procesit të akreditimit.

Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, GVB është bërë pjesë e trajnimeve paraprake të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit, mbi bazën e përvojës së vlerësimeve të mëparshme, duke hartuar edhe një plan pune, duke ndarë detyrat dhe duke udhëzuar GVB për përmbushjen e detyrave.

Për hartimin e këtij raporti, GVB organizoi takime me stafin akademik, administrativ, atë mbështetës si dhe me studentët.

Gjithashtu u shfrytëzuan të gjitha materialet, të dhënat e Fakultetit, vlerësimet e kryera nga studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën.

Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane:

- Ligj nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Manuali i Vlerësimit Institucional të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri, 2016 - 2017
- Manual për Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit, APAAL 2015
- Udhëzimet e MAS-it
- Dokumente të veprimtarisë institucionale të Universitetit “Fan S. Noli”, më konkretisht:
- Statuti i UK-së,
- Rregullore e UK-së,
- Rregullore e Programeve të studimit
- Rregullore e transferimeve
- Planet mësimore
- Syllabuset e lëndëve

I PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN:

PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”, 180 KREDITE (ME KOHË TË PLOTË)

Programet e studimit Bachelor që ofron Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane

- Bachelor në Filozofi-Sociologji

Programi i studimit Bachelor në Filozofi-Sociologji u çel në vitin 2002, me vendim të Këshillit të Ministrave dhe numër protokolli 22007/2. Ky program studimi realizohet sipas kriterëve të sistemit të Bolonjës, me kohë të plotë dhe ka kohëzgjatje normale 3 vite akademike, gjatë të cilave

realizohen 180 kredite. Këto vite akademike organizohen në 6 semestra me 15 javë mësimore secila (pa javët e sezonit të provimeve).

Ky program studimi synon që studenti:

- Të pajiset me njohuri bazë të fushën e filozofisë dhe të historisë së mendimit filozofik.
- Të njohë dhe të kuptojë, teoritë kryesore në fushën e sociologjisë, të moralit dhe të politikës.
- Të pajisë studentët me aftësi të përgjithshme për studimin e shkencave humane.
- Të aftësojë studentët në zhvillimin e kompetencave, për t'ju përgjigjur pozitivisht sfidave të studimeve të ciklit të dytë.
- Të formohet nga pikpamja shkencore dhe profesionale me koncepte në fushën e Filozofisë dhe Sociologjisë.
- Të aplikojë konceptet teorike themelore duke përdorur metoda shkencore e mjete të përshtatshme.

Bachelor në Administrim dhe Politika Sociale

Ky program studimi ka kohëzgjatje normale 3 vite akademike, gjatë të cilave realizohen 180 kredite. Këto vite akademike organizohen në 6 semestra me 15 javë mësimore secila (pa javët e sezonit të provimeve).

Programi i ciklit të parë Administrim dhe Politika Sociale, synon të realizojë formimin akademik të studentëve, aftësimin profesional në lidhje me administrimin dhe politikat sociale, si dhe kualitetet që kërkon tregu i punës.

Konkretisht, nëpërmjet këtij programi i studimit të ciklit të parë synohet në:

- Formimin e studentëve të kualifikuar me njohuri dhe kapacitete të nevojshme në fushën e administrimit dhe politikave sociale.
- Pajisjen me njohuritë teorike, prezantimin e metodave dhe instrumentave të analizës së fenomeneve me të cilat përballet administrata publike, për t'ju përgjigjur kërkesave të reja në kushtet e zhvillimit të shoqërisë shqiptare në kuadrin e integritimit në strukturat politike dhe sociale të BE.
- Përgatitjen e studentëve me vizionin dhe aftësitë e duhura në lidhje me përmirësimin e mekanizmave dhe institucioneve të politikave sociale, duke formuar burime njerëzore të kualifikuara në këto shërbime.

- Formimin e studentëve me elementët bazë të etikës profesionale në sferën e shërbimeve sociale duke përmirësuar marrëdhënien dhe komunikimin social si faktorë të rëndësishëm në përmbushjen e nevojave shoqërore.

- Bachelor në Matematikë – Fizikë

Programi i studimit Bachelor në Matematikë – Fizikë ka kohëzgjatje normale 3 vite akademike, gjatë të cilave realizohen 180 kredite. Këto vite akademike organizohen në 6 semestra me 15 javë mësimore secila (pa javët e sezonit të provimeve). Ky program studimi ka për synim të përgatitë studentin me konceptet bazë të Matematikës dhe të Fizikës. Në matematikë studenti mëson bazat e analizës matematike, algjibrës së lartë, gjeometrisë si dhe të probabilitetit, statistikës dhe matematikës së zbatuar. Në Fizikë studenti mëson bazat e fizikës së përgjithshme, si dhe më në veçanti të mekanikës teorike dhe kuantike, optikës, teorisë së relativitetit, elektrodinamikës etj. Me marrjen e diplomës Bachelor në Matematikë-Fizikë, studenti është në gjendje të vazhdojë Masterin Profesional për Mësimdhënie në Matematikë dhe Fizikë, Masterin Shkencor në Matematikë ose Fizikë.

- Bachelor në Matematikë – Informatikë

Programi i studimit Bachelor në Matematikë – Informatikë ka kohëzgjatje normale 3 vite akademike, gjatë të cilave realizohen 180 kredite. Këto vite akademike organizohen në 6 semestra me 15 javë mësimore secila (pa javët e sezonit të provimeve). Ky program studimi ka për synim të përgatitë studentin me konceptet bazë të Matematikës dhe të Informatikës. Në matematikë studenti mëson bazat e analizës matematike, algjibrës së lartë, gjeometrisë si dhe të probabilitetit, statistikës dhe matematikës së zbatuar. Në Informatikë studenti mëson elementët e programimit dhe gjuhë programimi, algoritmikën, arkitekturën e kompiuterave, rrjeta kompiuterike etj.

Me marrjen e diplomës Bachelor në Matematikë-Informatikë, studenti është në gjendje të vazhdojë Masterin Profesional për Mësimdhënie në Matematikë dhe Fizikë me profil minor Informatikë, Masterin Shkencor në Matematikë ose Informatikë.

- Bachelor në Teknologji Informacioni

Programi i studimit Bachelor në Teknologji-Informacioni ka kohëzgjatje normale 3 vite akademike, gjatë të cilave realizohen 180 kredite. Këto vite akademike organizohen në 6 semestra me 15 javë mësimore secila (pa javët e sezonit të provimeve). Në përfundim të këtij programi studimi, studenti merr formimin bazë metodologjik, shkencor dhe praktik në disiplinat që përmban kurrikula e këtij programi studimi. Pas marrjes së diplomës hidhet hapi i parë drejt formimit të specialistëve të

teknologjisë së informacionit, veçanërisht administratorëve të sistemit, administratorëve të rrjetave kompjuterikë, të databazave, programuesve, zhvilluesve të faqeve të web-it. Marrja e diplomës Bachelor në “Teknologji Informacioni” i jep mundësi studentit për të vazhduar studimet e ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master Shkencor”. Gjithashtu u jep mundësinë për të punuar si specialist i teknologjisë së informacionit në institucione dhe ndërmarrje të ndryshme private dhe shtetërore. Veçanërisht si administratorë sistemi, mirëmbajtës dhe ekspert mbështetës i rrjetave kompjuterike, databazave, zhvillues programesh, dizenjues web-i. Objektivat kryesore të programit të studimit janë që:

- T’u mundësohet studentëve që të fitojnë njohuri teorike dhe praktike për teknologjinë e informacionit dhe t’i aplikojnë këto njohuri.
- Të diplomuarit do të fitojnë aftësi në fushat kryesore të TIK siç mund të jenë bazat e programimit, teknologjitë kryesore të internetit, rrjetat kompjuterike, bazat e elektronikës.
- Të diplomuarit do të jenë të aftë të implementojnë teknologjitë e reja të internetit dhe rrjeteve në ndihmë të rritjes së efikasitetit dhe transparencës së shërbimeve të ndryshme.
- T’i aftësojë studentët që të marrin pjesë në zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjeve të ndryshme telematike.
- T’i aftësojë studentët që të marrin pjesë në zhvillimin dhe implementimin e programeve të ndryshme aplikative në ndihmë të zgjidhjes së problemeve.
- T’i aftësojë studentët që të punojnë në projekte individuale dhe në grup, të cilat sipas natyrës mund të jenë: projekte shkencore-hulumtuese, projekte zhvillimore ose punë praktike.

- Bachelor në Biologji – Kimi

Ky program studimi u çel gjatë vitit akademik 2013-2014, mbështetur në udhëzimet e Ministrit të Arsimit nr.4, datë 22.1.2008, nr.15, datë 04.04.2008.

Synimet kryesore të programit janë:

- Pajisja e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për arritjen e standardeve të larta në mësimdhënien në shkollat ku do të punojnë, duke zbatuar teorinë dhe praktikën e arsimit në lidhje me karakteristikat e grupmoshave, përparësitë e arsimit në vendin tonë dhe rolin e mësuesit si profesionist në një kontekst social në ndryshim.
- Paraqitja dhe përpunimi i metodave dhe mënyrave të ndryshme për një mësim aktiv dhe gjithpërfshirës.

- Realizimi i përgatitjes profesionale të studentëve duke u përqëndruar në çështje të tilla si, strategjitë e të nxënit, puna kërkimore dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Zhvillimi i aftësive praktike dhe profesionale të studentëve duke përdorur metoda që sigurojnë një përvetësim aktiv.
- Ruajtja e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare
- Në përfundim të këtij kursi studimi studenti merr formimin bazë metodologjik, shkencor dhe praktik në disiplinat që përmban kurrikula e degës “Biologji-Kimi”.
- Pas marrjes së Diplomës “Bachelor” hidhet hapi i parë drejt profesionit të mësuesit për sistemin parauniversitar si në shkollat publike dhe jopublike, duke iu përgjigjur sa më mirë tregut të punës.
- Diploma “Bachelor” në Biologji-Kimi jep mundësi për të vazhduar studimet e Ciklit të Dytë “Master Profesional” dhe “Master Shkencor”.

Diploma “Bachelor” në Biologji-Kimi e lëshuar prej Universitetit “Fan.S.Noli” në Korçë, përveç aksesit për të vazhduar studimet e ciklit të dytë të jep mundësinë për të punuar si:

- Mësues në arsimin parauniversitar publik ose jopublik.
- Punonjës për institute të ndryshme, shtetërore ose private që merren me shërbime ose punë kërkimore në biologji dhe kimi.

- Bachelor në Infermieri e Përgjithshme

- Bachelor në Mami Infermier

Departamenti i Infermierisë ofron programe studimi të ciklit të parë në fushat e studimit: Infermier i Përgjithshëm dhe Infermier Mami. Këto programe realizohen me 180 kredite me kohëzgjatje tre vjeçare (koha e plotë) dhe katër vjeçare (koha e pjesshme). Programet ofrojnë njohuri bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme dhe aftësi të veçanta profesionale në fushën e infermieristikës. Në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë lëshohet *Diplomë Bachelor* në fushën e studimit të kryer.

Synimi i këtij programi studimesh synon të:

- Pajisë studentët me njohuri dhe aftësi praktike në fushën e kujdesit infermior; studentët duhet të kenë njohuri bazë rreth funksioneve fiziologjike dhe sjelljes në kushte normale dhe në rast sëmundjeje.
- Studentët në fund të këtij programi studimesh, duhet të jenë të aftë të marrin anamnezë, të kryejnë ekzaminimin fizik dhe të vendosin diagnozën infermiore duke planifikuar ndërhyrjet e nevojshme tek pacienti.

- Të kenë njohuri bazë rreth kodit etik të infermierit; të njohin deklaratën e të drejtave të njeriut e të pacientit.
- Infermieri duhet të jetë i aftë të marrë pjesë në planifikim dhe zbatimin e procedurave teknike/mjekësore tek pacientët.
- Infermieri duhet të jetë i aftë të ndihmojë pacientin në aktivitetet bazë të jetës duke marrë parasysh dinjitetin dhe diferencat kulturore.
- Infermieri duhet të dijë si të ruajë cilësinë e kujdesit ndaj pacientit në rastet e hospitalizimit.
- Infermieri duhet të aftë të plotësojë dokumentacionin e duhur mjekësor; të informojë punonjësit e tjerë duke ruajtur konfidencialitetin dhe të drejtat e pacientit.
- Infermieri duhet të njohë situatat e rrezikshme për jetën dhe të japë mjekimin e duhur në rast urgjence.
- Të edukojë pacientin dhe familjarët me qëllim promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve.
- Duhet të dijë të aplikojë procedurat teknike mjekësore tek pacienti.
- Duhet të dijë si të marrë masa sigurie gjatë punës.
- Infermieri duhet të jetë trajnuar për aftësitë bazë të komunikimit; të punojë në mënyrë të pavarur; të dijë të punojë në grup
- Të jetë i përgatitur për procesin e mësimin gjatë gjithë jetës për zhvillimin e tij profesional me qëllim përf forcimin e kompetencave lidhur me nevojat dhe kërkesat e kohës.

Emërtimi i programit të studimit	Vendime
Filozofi - Sociologji	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 22007/2, datë 17.06. 2002
Administrim dhe Politika Sociale	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 3167/2 datë 04.04. 2013
Matematikë - Fizikë	Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr. 833, datë. 04.06.2008
Matematikë Informatikë	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 833 datë 04.06. 2008
Teknologji Informacioni	Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr 518, datë 30.06.2010
Biologji - Kimi	1.Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.352, datë 12.05.2010 2. Vendimi i Senatit akademik të Universitetit

	“Fan S. Noli” Vendimi Nr.11, datë 16.03.2010 3. Vendimi i Këshillit të Fakultetit:Vendimi Nr.4, datë 23.09.2013 Miraton ndryshimet në planin mësimor të deges Biologji-Kimi
Infermieri e Përgjithshme	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.369, datë 10.07.1995
Mami Infermier	Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Nr 5353, datë 22.08.2005

PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL”, 90 KREDITE (ME KOHË TË PLOTË)

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ofron programet e studimit:

-Mësuesi për arsimin e mesëm në shkenca sociale me profil minor në "Edukim Qytetar dhe Demokratik"

Ky program studimi ka kohëzgjatje normale 1.5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik, gjatë të cilit realizohen 90 kredite. Në përfundim të këtij cikli studimesh lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Filozofi-Sociologji” me profil minor në “Edukim Qytetar”. Ky program studimi synon formimin shkencor dhe intelektual të studentëve në fushën e Filozofisë dhe Sociologjisë. Në përfundim të këtij programi, studentët do të gjejnë mundësi punësimi në arsimin parauniversitar.

-Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë - Fizikë me profil minor në "Informatikë"

Programi i studimit ka për qëllim aftësimin e studentëve me njohuritë kryesore pedagogjike, kulturore dhe metodike për t’i bërë mësues të mirë profesionistë në të ardhmen. Gjithashtu ata pajisen me njohuri të bazë dhe avancuara në fushat kryesore të teknologjisë së informacionit, për të plotësuar nevojat e tyre për informacion, komunikim, rritur cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve dhe si rrjedhim për të qënë mësues të mirë edhe në këto fusha neqoftëse e kërkon nevoja.

Objektivat e programit të studimit:

1. Të diplomuarit do të marrin njohuri bazë pedagogjike, kulturore dhe mbi metodat bazë të kërkimit si dhe do të aftësohen që këto njohuri të ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

2. Të diplomuarit do të marrin njohuritë kryesore të metodikës së fizikës dhe matematikës si dhe do të njihen me metodat e reja të mësimdhënies dhe të mësuarit si dhe do të aftësohen për të zbatuar ato në praktikë.
3. Të diplomuarit do të fitojnë njohuritë në lidhje me ndikimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në mësimdhënien dhe të mësuarit si dhe gjatë procesit të mësimdhënies. Gjithashtu do të jepen edhe konceptet bazë të teorisë dhe praktikës të mësimdhënies dhe të mësuarit në internet sot.
4. Të diplomuarit do të fitojnë aftësinë për të fushat kryesore të TIK sic mund të jenë bazat e programimit, teknologjitë kryesore të internetit, rrjetat kompjuterike etj.
5. Të diplomuarit do të jenë të aftë të implementojnë teknologjitë e reja të internetit në ndihmë të rritjes së efikasitetit dhe transparencës së shërbimeve të ndryshme.

-Mësimdhënie për mësuesit e Biologji – Kimisë

Ky program studimi u çel gjatë vitit akademik 2013-2014, mbështetur në udhëzimet e Ministrisë të Arsimit nr.4, datë 22.1.2008, nr.15, datë 04.04.2008, dhe udhëzimin e datës 22.6.2010 për programin e Masterit Profesional në Mësimdhënie.

Synimet kryesore të programit janë:

- Të përgatisë mësimdhënës të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale dhe cilësi të larta morale dhe shoqërore për t'u kthyer në modele frymëzuese dhe motivuese për nxënësit;
- Të përgatisë mësimdhënës të aftë për të punuar dhe për të ndihmuar në komunitet;
- Të përgatisë mësimdhënës të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e Shqipërisë dhe më gjerë për të ndihmuar në zhvillimin e tyre.

Synimi final i programit është që të përgatisë specialistë të zotë që të thithen nga tregu i punës, si në arsimin publik ashtu dhe në atë jopublik.

-Teknologji Informacioni

Ky program studimi ka për qëllim aftësimin e profesionistëve me njohuri të avancuara në fushat kryesore të teknologjisë së informacionit, të integrojnë zgjidhjet që ofron teknologjia e informacionit me ato të proceseve të biznesit dhe institucioneve të ndryshme për të plotësuar nevojat e tyre për informacion, komunikim, për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve dhe si rrjedhim duke u mundësuar atyre arritjen e objektivave të tyre në një mënyrë efektive dhe eficiente.

Objektivat e programit të studimit:

1. Të diplomuarit do të mund të arrijnë të zgjidhin probleme të ndryshme duke identifikuar, analizuar, zhvilluar dhe implementuar zgjidhje bazuar në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.
2. Të diplomuarit do të fitojnë aftësinë për të projektuar, implementuar, mirëmbajtur dhe përditësuar sistemet e teknologjive të informacionit dhe komunikimit në biznese dhe institucione të ndryshme duke rritur shkallën e efikasitetit të tyre.
3. Të diplomuarit do të jenë të aftë të planifikojnë, drejtojnë, organizojnë dhe marrin pjesë në grupe pune dhe projekte në grup që mundësojnë arritjen e zgjidhjeve të suksesshme të sistemeve të informacionit dhe brenda organizatës.
4. Të diplomuarit do të fitojnë mundësinë për të kuptuar funksionet dhe aplikimet e kompjuterave në mjedisin e sistemeve të informacionit dhe të aplikojnë këtë kuptueshmëri brenda organizatës, strukturave dhe proceseve të biznesit.
5. Të diplomuarit do të mund të tregojnë aftësinë për të ndërtuar aplikacione të avancuara në ndihmë të zgjidhjes së problemeve në organizata ose në biznese të ndryshme.
6. Të diplomuarit do të jenë të aftë të implementojnë teknologjitë e reja të internetit në ndihmë të rritjes së efikasitetit dhe transparencës së shërbimeve të institucioneve qeveritare dhe të bizneseve të ndryshme.

-Infermieristikë

Programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në Infermieristikë ofron mundësi për formim të vazhdueshëm dhe kualifikim të mëtejshëm profesional të gjithë studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve në Infermieri të përgjithshme, ose fusha të përafërta, apo të ngjashme me të. Ky program realizohet me 90 kredite me kohëzgjatje 1 vit e gjysëm, 3 semestra. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë: Master i Nivelit të Parë. Forma e studimit; kohë e plotë.

Në përfundim të studimeve Master Profesional në Infermieristikë, diplomanti do të jetë i aftë:

- Të aplikojë konceptet, teoritë, parimet e shkencës së Infermieristikës, të demostrojë kompetencat në praktikë, të praktikojë si një infermier specialist.
- Të demostrojë cilësitë e liderit dhe të funksionojë në mënyrë të efektshme si edukator dhe menaxher.

- Të demonstron aftësi në kryerjen e kërkimit infermieror, në interpretimin dhe shfrytëzimin e përfundimeve të kërkimeve nga fusha e shëndetësisë.
- Të paraqit aftësi për planifikim dhe ndryshime efektive në praktikën infermierore dhe sistemin e shërbimeve shëndetësore, të vendosë marrëdhënie bashkëpunuese me punonjësit e disiplinave të tjera.
- Të shfaqë interes në mësimin e vazhdueshëm për përmirësimin profesional.

Emërtimi i programit të studimit	Vendime
Mësuesi për arsimin e mesëm në shkencë sociale me profil minor në "Edukim Qytetar dhe Demokratik"	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1337 datë 10.10.2008.
Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë - Fizikë me profil minor në "Informatikë"	Urdhër ministrit të arsimit dhe shkencës. Nr. 7003/4 Nr. 507, Datë 08.11.2010
Mësimdhënie për mësuesit e Biologji – Kimisë	1.Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 744, date 05.09.2013 2.Vendimi i Senatit akademik të Universitetit F.S. Noli: Nr. 10 date 29.03.2013 3.Vendimi i Senatit akademik të Universitetit F.S. Noli (Miratohen ndryshimet): Nr. 37, date 30.04.2015
Teknologji Informacioni	1.Vendimi i Këshillit të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane (FSHNH), Datë 08.07.2013 2. Vendimi i Senatit akademik të Universitetit “Fan S. Noli” te Korçës (UNKO), Datë 11.07.2013
Infermieristikë	Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr 177, datë 06.05.2015

II - STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, në vitin akademik 2011-2012, u përcaktua si një njësi e re dhe tepër e rëndësishme e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë. Në zbatim të Urdhërit nr. 16, datë 17.1.2012 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, mbështetur në nenin 102 të

Kushtetutës dhe në nenin 41 të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” u bë riorganizimi i Fakultetit të Mësuesisë i themeluar në vitin 1992, në dy Fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
2. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane ka në përbërje të tij tre Departamente, dhe dy grupe mësimore - kërkimore: një grup mësimor - kërkimor të atashuar në Departamentin e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës si dhe një grup mësimor kërkimor të atashuar në Departamentin e Infermierisë.

Fakulteti ka një bashkëpunim shumë të frytshëm me disa fakultete homologe në Rajon dhe në Europë. Përmendim këtu Universitetin Kirili e Metodi, Maqedoni; Universitetin Aristoteli, Selanik, Greqi; Universitetin e Prishtinës; Universitetin e Sofies, Bullgari etj. Në këto Universitete, pedagogë të ndryshëm kanë realizuar kualifikime afatshkurtra dhe afatgjata, duke përfutur nga eksperiencia e tyre. Ndërkohë, disa studentë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, kanë realizuar dhe punimet e diplomave të tyre në këto Universitete.

Të gjitha këto janë kyçi i suksesit tonë në përgatitjen e profesionistëve në fushën e Sociologjisë, mësuesve profesionistë të Filozofisë dhe Sociologjisë, të Matematikës dhe Fizikës, të Biologji - Kimisë, profesionistëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Infermierëve të përgjithshëm dhe Mami, të një niveli të lartë shkencor, me dije bashkëkohore dhe me mundësi punësimi shumë të larta.

Reforma më e madhe arsimore e kryer së fundmi është strukturimi i programeve të studimit në përputhje me parimet e hedhura në Deklaratën e Bolonjës dhe në të gjitha dokumentat e tjera pasuese, të cilat gjejnë pasqyrimin e tyre në Ligjin Nr.9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në amendamentet e pasqyruara në ligjin Nr.10307, datë 22.07.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9741”, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kështu sot në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, arsimimi i lartë është i organizuar në dy cikle, duke ofruar dy nivele diplomash; lëndët janë të organizuara në module dhe ngarkesa e tyre shprehet në kredite; programet e studimit janë të gjitha bashkëkohore. Ato ndjekin programet e studimit të fakulteteve homologe, kryesisht të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Fakultetit të Shkencave Sociale, në Universitetin e Tiranës, por edhe të Rajonit. Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diploma përkatëse dhe suplementin e diplomës; studentët kanë mundësinë e transferimit të krediteve nga një Institucion tjetër i Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe të pajisen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për tu larguar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane në një IAL tjetër.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ka pësuar përmirësime dhe zhvillim edhe në drejtimin institucional, duke u organizuar mbi bazën e Departamenteve dhe funksionimin e organeve kolegjiale në vendimmarrje. Kështu në Fakultet funksionon normalisht Këshilli i Fakultetit, i cili është organ kolegjial vendimmarrës. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit, shkalla e gjerë dhe e balancuar e përfaqësimit, funksionet që kryen dhe autoriteti vendimmarrës të shprehura në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren e brendshme të Fakultetit garantojnë një autonomi të brendshme institucionale në menaxhimin e Fakultetit dhe të njësisë të tij bazë.

Në Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane është shtuar dhe Qendra e Ekselencës, Mbështetur në udhëzimet e MASH, Urdhër nr. 110, dt. 09.03.2011 për: “Nevojat për Trajnimin e Mësuesve dhe Drejtuesve të Arsimit Parauniversitar”, e cila përbën një njësi bazë, kërkimore dhe trajnuese. Kjo qendër ka si mision të vetin, formimin cilësor të specialistëve në fushat përkatëse dhe promovimin e kërkimit shkencor në shkencat e natyrës dhe ato humane. Ajo funksionon si njësi trajnuese dhe kërkimore në fushën e Didaktikës së Shkencave, e çertifikuuar dhe akredituar nga MASH.

Krahas përqëndrimit të veprimtarisë kërkimore të Fakultetit, Qendra e Ekselencës zhvillon një aktivitet të gjerë trajnues duke ofruar programe për mësuesit në shërbim në Rajonin e Korçës dhe më gjerë, në fushat:

- a. Drejtim dhe administrim i shkollës;
- b. Shkenca sociale: Filozofi, Sociologji;
- c. Shkencat natyrore: Matematikë, Fizikë, Informatikë, Biologji, Kimi,

Këto programe trajnimi synojnë zhvillimin e shprehive në mësimdhënie, të praktikave mësimore, si dhe të aftësive të drejtimit për personelin në detyrë.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ka patur një dinamikë të lartë zhvillimi në vitet e fundit: në drejtim të zhvillimit të programeve në të dy ciklet e studimit, duke krijuar programe krejtësisht të reja dhe rikompozim të përgjithshëm, të kujdesshëm të atyre ekzistuese në përputhje me kërkesat e reformës së Bolonjës dhe në drejtim të rritjes së numrit të studentëve, rritjes së stafit akademik në numër dhe në kualifikim dhe të atij ndihmës.

DEPARTAMENTET:

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ka aktualisht **56** punonjës, prej të cilëve 49 janë staf akademik dhe 7 punonjës janë staf ndihmës mësimor.

Departamentet dhe grupet mësimore në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane

DEPARTAMENTI	GRUPET MËSIMORE DHE KËRKIMORE
Departamenti i Shkencave Sociale	
Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës	Informatika dhe Fizika
Departamenti i Infermierisë	Biologji – Kimia

1. **Departamenti i Shkencave Sociale** përbën një nga njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë. Në përpjekje për të plotësuar objektivat e vendosura si njësi brenda Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, ky departament synon:

- Të përgatisë studentë me formim të gjerë filozofik, sociologjik, kulturor, si dhe formim e kualifikim të tyre me njohuri dhe kapacitete të nevojshme në fushën e administrimit dhe politikave sociale; jo vetëm për të vazhduar studimet e ciklit të dytë, por edhe për t’u krijuar atyre hapësira për punësim.
- Të jetë atraktiv për të gjithë ata që dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta, nëpërmjet ndryshimit e rishikimit sasior e cilësor të kurrikulave, përmirësimit të infrastrukturës dhe kualifikimit të kuadrit akademik, por edhe nëpërmjet hartimit të paketave reklamuese të kapaciteteve të departamentit.
- Rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Përsosjen e vazhdueshme të kurrikulave.
- Kualifikimin e stafit akademik.
- Pjesëmarrjen në projekte dhe konferenca shkencore.
- Forcimin e mëtejshëm të lidhjeve dhe shkëmbimeve me fakultete homologe brenda dhe jashtë vendit mbi bazën e traditës së krijuar.

Këto objektiva janë hartuar në përputhje me strategjitë për zhvillim të universitetit dhe janë pasqyruar në dokumentacionin e Fakultetit dhe në programet mësimore për t’u bërë të njohura për studentët.

Departamenti i Shkencave Sociale ka në përbërje 13 pedagogë, prej të cilëve:

- 1 Prof. dr.
- 1 Prof. as.dr
- 1 Dr.
- 1 Docent
- 9 Msc (prej të cilëve 8 Doktorantë)

2. Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, si njësi brenda Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, për të realizuar plotësimin e objektivave të vendosura, ndër të tjerash synon:

- Të përgatisë studentë cilësorë me një formim mjaft të mirë në matematikë, informatikë dhe fizikë duke synuar vazhdimësinë e studimeve dhe kualifikimin e tyre të mëtejshëm.
- Të realizojë edukimin profesional e shkencor të studentëve në nivelin më të lartë cilësor përmes programeve të përparuara të arsimit dhe kërkimit shkencor.
- Të përgatisë mësues të arsimit të mesëm të ulët në Matematikë, Informatikë dhe Fizikë si dhe specialistë të Teknologjisë së Informacionit, për të përballuar me sukses nevojat e tregut të punës dhe sfidat e zhvillimit të sektorit arsimor dhe më gjerë.
- Të realizojë një rritje të nivelit të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke përmirësuar në vazhdimësi kurrikulat.
- Kualifikimin e stafit akademik.

Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës ka në përbërje 20 pedagogë, prej të cilëve:

- 1 Prof. Dr
- 1 Prof. Asc.Dr
- 3 Dr
- 15 Msc (prej të cilëve 11 Doktorantë)

3. **Departamenti i Infermierisë** është krijuar në tetor të vitit 1994, nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë, me një numër prej 65 studentësh. Stafi i tij përbëhej nga 7 mjekë. Në vitin 1995, ai kaloi nën varësinë e Universitetit "Fan S.Noli" Korçë, me emërtimin Dega Infermieri, duke plotësuar të gjitha kërkesat e një shkolle Universitare. Qëllimi i shkollës ishte përgatitja e infermierëve me arsim të lartë. Në katër vitet e para mësimi u realizua nga mjekë dhe pedagogë të ish-Shkollës së mesme Mjekësore, me synim përfshirjen e infermierëve të kualifikuar në mësimdhënie; në dallim nga shkollat e tjera të Infermierisë në vend, të cilët përfshijnë në mësimdhënie infermierë me arsim të mesëm apo kurs 2-vjeçar. Në vitin 2005, krahas programit të studimit të ciklit të parë Bachelor *Infermier i Përgjithshëm*, u çel edhe programi i studimit i ciklit të parë Bachelor Infermier Mami. Në vitin akademik 2010-2011 u çel programi i studimit Bachelor Infermier i Përgjithshëm, në sistemin me kohë të pjesshme. Në vitin akademik 2013-2014 u çel program i ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Infermieristikë.

Misioni i Departamentit të Infermierisë si pjesë e Universitetit "Fan S.Noli" është të realizojë edukimin profesional e shkencor të studentëve në nivelin më të lartë cilësor përmes programeve të përparuara të arsimit dhe kërkimit shkencor.

Objektivat e këtij Departamenti janë përgatitja e infermierëve specialistë për të përballuar me sukses nevojat e tregut të punës dhe sfidat e zhvillimit të sektorit të shërbimit shëndetësor në të tre nivelet e tij dhe në komunitet.

Të diplomuarit në ciklin e parë të studimeve Bachelor Infermier i Përgjithshëm do të jenë të aftë:

- Të demonstrojnë kompetenca lidhur me vlerat etike dhe ndryshimet kulturore;
- Të përdorin dhe integrojnë njohuritë, procedurat dhe teoritë infermierore
- Të kryejnë promocionin shëndetësor dhe të menaxhojnë sëmundjet duke përdorur njohuritë infermierore
- Të luajnë rolin e infermierit profesionist si dizenjues, menaxhues dhe koordinues të kujdesit shëndetësor
- Të demonstrojnë aftësitë si udhëheqës dhe menaxhues; aftësi teknike të të mësuarit dhe bashkëpunuese në situatat e ndryshme klinike.

Me zhvillimin e vazhdueshëm të të gjithë sektorëve të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, edhe Dega e Biologji-Kimisë ka pësuar evolucionin e saj në drejtimin didaktik, shkencor, organizativ.

Grupi mësimor kërkimor i Biologji-Kimisë ushtron veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore në përmbushje të misionit të tij në drejtimet e:

- formimit universitar të studentëve;
- kërkimin shkencor bazë.

Ky grup mësimor-kërkimor ka kapacitete njerëzore dhe laboratorike, të cilat i ka vënë në shërbim të mirëintegritit të mësimdhënies me kërkimin shkencor.

Misioni i këtij grupi mësimor-kërkimor është të sigurojë një mësimdhënie me nivel të lartë të disiplinave të Biologji-Kimisë duke ofruar performancë dhe cilësi të lartë në kurset tona, kurrikula dhe teknologji të reja në mësimdhënie. Në kërkimin shkencor misioni ynë është zhvillimi i kërkimit shkencor dhe integrimi i punës shkencore me mësimdhënien, organizimi i veprimtarive shkencore me karakter lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Strukturimi i grupit të ri ka synuar që ndarjes në dy drejtime bazë Biologji dhe Kimi ti atashojë dhe laboratorët në shërbim të realizimit të misioneve respektive.

Në këtë kuadër, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane funksionojnë laboratorët e Biologjisë dhe Kimisë.


Departamenti i Infermierisë ka në përbërje 16 pedagogë, prej të cilëve:

Shpërndarja e stafit akademik sipas titujve dhe gradave në departamente							
Departamenti	Prof.Dr	Prof. As.Dr.	Dr.	Doc.	Doktorantë	Msc.	Totali
Shkenca Sociale	1	1	1	1	8	1	13
Matematikë, Informatikë dhe Fizikë	1	1	3	-	11	4	20
Infermieri	-	-	3	1	4	8	16
Totali	2	2	7	2	23	13	49

3 Dr
1 Docent
12 Msc (prej të cilëve 4 Doktorantë)

Struktura e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane jepet në organogramën e mëposhtme:

ORGANOGRAMA



III - ANALIZA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE DIPLOMAVE

a) **Diplomat.** Fakulteti jep diploma për këto programe studimi Bachelor me emërtimet:

Bachelor në Filozofi-Sociologji
Bachelor në Administrim dhe Politika Sociale
Bachelor në Matematikë – Informatikë
Bachelor në Matematikë – Fizikë
Bachelor në Teknologji Informacioni
Bachelor në Biologji – Kimi
Bachelor në Infermieri e Përgjithshme
Bachelor Mami Infermier

b) **Statistikat e pranimit në Fakultet, sistemi me kohë të plotë, Niveli Bachelor, viti akademik 2015-2016, janë si më poshtë:**

Programi i Studimit	Cikli i Studimit BA/MP, Msc	GJITHSEJ PRANIME	VITI 1	
			F	M
Administrimi dhe Politika Sociale	BA	64	51	12
Biologji Kimi	BA	38	31	7
Filozofi Sociologji	BA	46	28	18
Infermieri e përgjithshme	BA	102	66	36
Mami (Infermieri)	BA	52	46	6
Matematikë Fizikë	BA	27	14	13
Matematikë Informatikë	BA	29	18	11
Teknologji Informacioni	BA	50	11	39
Infermieristikë	MP	75	60	15
Mësimdhënie për mësuesit e Biologji Kimisë	MP	25	21	4
Mësuesi në Matematikë dhe Fizikë me profil minor në Informatikë	MP	26	20	6
Mësuesi në Shkencat Sociale me profil minor Edukim qytetar demokratik	MP	33	29	4
Teknologji Informacioni	MP	21	2	19

c) Numri i studentëve për çdo kurs studimi sipas Programeve të studimit, Niveli Bachelor dhe Master, për vitin akademik 2015 – 2016.

Programi i Studimit	Forma e Studimit (KP/KPj)	Cikli i Studimit BA/MP, Msc	VITI 1		GJITHSEJ	VITI 2		GJITHSEJ	VITI 3		GJITHSEJ	VITI 4		GJITHSEJ	
			F	M		F	M		F	M		F	M		
Filozofi-Sociologji	KP	BA	28	25	53	22	11	34	30	12	42				129
Administrim dhe politika sociale	KP	BA	61	18	79	48	27	75	48	18	66				220
Matematikë-Informatikë	KP	BA	18	14	32	21	11	32	21	14	35				99
Matematikë-Fizikë	KP	BA	15	13	28	13	5	18	9	6	15				61
Teknologji-Informacioni	KP	BA	11	51	62	12	47	59	15	45	60				181
Biologji-Kimi	KP	BA	23	16	39	12	8	30	25	18	43				112
Infermier i Përgjithshëm	KP	BA	80	48	121	85	36	121	13	90	227				469
Mami (Infermier)	KP	BA	61	12	73	30	9	39	57	30	87				199
Infermier i Përgjithshëm	KPj	BA			-		1	1	14	5	19	18	8	26	46
Mësuesi për arsimin e mesëm në shkencë sociale me profil minor në "Edukim Qytetar dhe Demokratik"	KP	MP	30	2	32	21	6	27							59
Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë - Fizikë me profil minor në "Informatikë"	KP	MP	18	7	25	21	6	27							59
Teknologji-Informacioni	KP	MP	2	19	21	8	21	29							50
Mësimdhënie për mësuesit e Biologji Kimisë	KP	MP	20	4	24	14	4	18							42
Infermieristikë	KP	MP	58	17	75	76	21	95							170

ç) Kalueshmëria sipas programeve të studimit, Niveli Bachelor. Viti akademik 2015 – 2016

Programi i Studimit	Forma e Studimit (KP/KPj)	Cikli i Studimit BA/MP, Msc	VITI	VITI	VITI	VITI
			1	2	3	4
Kalueshmëria në %						
Teknologji Informacioni	KP	BA	77	67	20	-
Biologji – Kimi	KP	BA	82	97	61	-
Filozofi – Sociologji	KP	BA	80	80	36	-
Matematikë – Fizikë	KP	BA	65	83	93	-
Matematikë – Informatikë	KP	BA	89	87	60	-
Infermier i Përgjithshëm	KP	BA	84	89	26	-
Mami Infermier	KP	BA	55	82	18	-
Administrim dhe Politika Sociale	KP	BA	92	82	47	-
Mësuesi për arsimin e mesëm në shkenca sociale me profil minor në "Edukim Qytetar dhe Demokratik"	KP	MP	91	96	-	-
Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë - Fizikë me profil minor në "Informatike"	KP	MP	96	100	-	-
Mësimdhënie për mësuesit e Biologji Kimisë	KP	MP	100	100	-	-
Teknologji Informacioni	KP	MP	86	97	-	-
Infermieristikë	KP	MP	100	96	-	-
Infermier i Përgjithshëm	KPj	BA	-	-	100	-

d) Studentët e diplomuar sipas programeve të studimit Viti akademik 2015 – 2016

Nr. i studentëve të diplomuar viti akademik 2015 – 2016			
Programet e Studimit	Cikli i studimit (Ba, MP, Msc)	Forma e studimit KP/KPj	Nr. i studentëve
Teknologji Informacioni	BA	KP	25
Biologji – Kimi	BA	KP	29
Filozofi – Sociologji	BA	KP	22
Matematikë – Fizikë	BA	KP	14
Matematikë – Informatikë	BA	KP	11
Infermier i Përgjithshëm	BA	KP	22
Mami Infermier	BA	KP	3
Administrim dhe Politika Sociale	BA	KP	31
Mësuesi për arsimin e mesëm në shkenca sociale me profil minor në "Edukim Qytetar dhe Demokratik"	MP	KP	26
Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në Matematikë - Fizikë me profil minor në "Informatike"	MP	KP	27
Mësimdhënie për mësuesit e Biologji Kimisë	MP	KP	16
Teknologji Informacioni	MP	KP	27
Infermieristikë	MP	KP	76
Infermier i Përgjithshëm	BA	KPj	16

Të diplomuar gjithsej për vitin akademik 2015 – 2016 në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve të studimeve

Programet e studimit	Sistemi 3 -vjeçar Bachelor	Sistemi me kohë të pjesshme	Master	Gjithsej (Sipas programeve të studimit)
Teknologji Informacioni	25	-	27	52
Biologji - Kimi	29	-	16	45
Filozofi - Sociologji	22	-	26	48
Matematikë - Fizikë	14	-	27	41
Matematikë - Informatikë	11	-	-	11
Infermier i Përgjithshëm	22	16	76	114
Mami	3	-	-	3
Administrim dhe politika sociale	31	-	-	31

IV - STAFI MËSIMDHËNËS DHE MBËSHTETËS

a) *Numri i stafit të brendshëm me kohë të plotë për vitin akademik 2015-2016 është si më poshtë:*

Viti akademik	Numri i pedagogëve
2015-2016	49

b) *Raporti midis stafit mësimdhënës dhe numrit të studentëve për çdo kurs studimi në vitin akademik 2015 – 2016:*

Programi i studimit	Sistemi i ditës
Filozofi-Sociologji	1:7
Administrim dhe politika sociale	1:10
Matematikë-Informatikë	1:5
Matematikë-Fizikë	1:3
Teknologji-Informacioni	1:7
Biologji-Kimi	1:5
Infermier i Përgjithshëm	1:13
Mami (Infermier)	1:6
Master profesional Mësuesi në Shkencat Sociale me profil minor Edukim qytetar demokratik	1:4
Master profesional Mësuesi në Matematikë dhe Fizikë me profil minor në Informatikë	1:4
Master profesional Teknologji-Informacioni	1:4

Master profesional Mësimdhënie për mësuesit e Biologji Kimisë	1:3
Master Profesional Infermieristikë	1:9

c) Ngarkesa mësimore për lëndët e çdo kursi studimi

Ngarkesa fizike e stafit të brendshëm në programin Bachelor

<i>Stafi i brendshëm</i>		<i>Ngarkesa fizike (Filozofi-Sociologji)</i>						
<i>Emër Mbiemër</i>	<i>Titulli / Grada</i>	<100	100-200	200-300	300-400	400-500	500-600	>600
Josif Minga	Prof. as. dr.		105					
Magdalini Vampa	Doktor	90						
Ardian Matka	Docent			242.6				
Maria Dojçe	Msc.					415.5		
Denisa Titili	Msc.			295.5				
Mitjana Profiri	Msc.				315			
Jordan Jorgji	Msc.		156					
Alket Dino	Msc.			214				
Suela Ibrahimllari	Msc.		102.2					
Eriseld Kalemaj	Msc.		105					
Viola Dolani	Msc.			236				
Ermona Braholli	Dr.		105					
Jorida Agolli	Msc.		105					
Marijon Pano	Msc.	22.5						

<i>Stafi i brendshëm</i>		<i>Ngarkesa fizike (Administrim dhe Politika Sociale)</i>						
<i>Emër Mbiemër</i>	<i>Titulli / Grada</i>	<100	100-200	200-300	300-400	400-500	500-600	>600
Magdalini Vampa	Doktor		157.5					
